

VENDIM
Nr. 45/2017

**PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT AD HOC ME 12 ANËTARË TË
PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT,
SIPAS LIGJIT NR. 84/2016, “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE
DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, dhe të nenit 9, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimet e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijimin e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* të për zgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” me 12 anëtarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare.

II. Përbërja e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* për për zgjedhjen e kandidatëve është si më poshtë:

a) Nga grupet parlamentare të shumicës parlamentare caktohen:

- | | | |
|----|---------------|--------|
| 1. | Pandeli Majko | (PS) |
| 2. | Bashkim Fino | (PS) |
| 3. | Ulsi Manja | (PS) |
| 4. | Evis Kushi | (PS) |
| 5. | Luan Rama | (LSI) |
| 6. | Mesila Doda | (PDIU) |

b) Nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen:

- | | |
|----|-------|
| 1. | _____ |
| 2. | _____ |
| 3. | _____ |
| 4. | _____ |
| 5. | _____ |
| 6. | _____ |

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir META

Miratuar në datën 18.4.2017